

Raporti Javor i Ndërmjetëm i Monitorimit

Monitorues : Eksperti financiar Eftali Qirjaqi (Auditues Ligjor)

Zgjedhjet : 30 Qershor 2019

Subjekti zgjedhor: "Partia Socialpunetore Shqiptare"

Bashki te monitoruara : Tirane, Lezhe, Kukës

Për: Komisionin Qëndror të Zgjedhjeve, Tiranë

Në zbatim të vendimit 740 date 31.05.2019 ora 10:00 "Për shpalljen e rezultatit të shortit për emërimin e ekspertëve financiar dhe audituesve ligjorë të cilët do të kryejnë monitorimin dhe auditimin e fondeve dhe shpenzimeve të fushatës zgjedhore nga subjektet zgjedhore për organet e qeverisjes vendore të vitit 2019", kontrates Nr..... date 07.06.2018, në lidhje me monitorimin e fushatës zgjedhore të Partise Socialpunetore Shqiptare, Ju paraqesim këtë Raport të Ndërmjetëm të periudhës nga 01.06.2019 deri 08.06.2019.

Në datën 06.06.2019, 07.06.2019 dhe 08.06.2019 kam kontaktuar me subjektin zgjedhor Partia Socialpunetore Shqiptare, saktësisht personi i komunikimit z, Femi Luca.

Nga verifikimi i listes shumecmerore sipas Bashkive, konstatuam se Partia Socialpunetore Shqiptare ka kandidatë në qarqet Kukës, Lezhë, Diber, Tirane dhe Vlore.

Monitorimi është kryer në Bashkinë Tiranë, Bashkinë Lezhë, Bashkinë Kukës. Kemi derguar shkresat për të marrë informacion me shkrim ose në rrugë informatike nga Bashkitë e sipercituara për të na dhene informacion me shkresë zyrtare në rrugë postare për subjektin zgjedhor Partia Socialpunetore Shqiptare.

Më datën 06.06.2019 në takimim me z.Femi Luca na informoi se nuk kanë zyra elektorale të hapura në asnjë rreth, adresa e selisë që shërbente dhe si zyre ishte një pjese nga apartamenti i z, Femi Luca me një sipërfaqe minimaliste. Takimet realizoheshin në kafe.

Nga verifikimi në terren :

Nuk u konstatuan zyra elektorale në qarkun Tirane, Lezhe dhe Kukës.

Nuk u konstatuan materiale të ndaluara në qarqet Tirane, Lezhe dhe Kukës.



Eftali Qirjaqi
AUDITUES LIGJOR
Licence Nr. 11 Date 11.01.2000, NIPV K465260781,
Lagje "Qemal Stafa", Rr. "Studenti", Shkodër
Mobile: +355682069434, +355692079434
Email: e.qirjaqi@yahoo.com

Nuk konstatojmë zyra me logon e Partisë Socialpunëtore Shqiptare.

Deri me datën e sotme 08.06.2019 nuk kemi marrë informacion nga Bashkëtesë nëse subjekti zgjedhor Partia Socialpunëtore Shqiptare ka marrë ambiente me qera pranë bashkive përkatëse.



Shkodër, më datë 08/06/2019